



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data: 02.11.2020]

Për: “ALSTEZO” SHA

Adresa: Lagjia Kryengritja e Fierit, Fier.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “**Kërkesë për propozim**” - **Shërbim** - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “**Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës**”, me fond limit: **1,666,660** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) **Lekë (pa TVSH)** dhe me nr. **REF-65655-07-15-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës**”, me fond limit: **1,666,660** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH dhe me nr. **REF-65655-07-15-2020** dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 20.07.2020, Nr.43.

Kriteret e për zgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1) “ALSTEZO” SHA **J63208420N**  
*Emri i plotë i shoqërisë* **numri i NIPT-it**  
Vlera: **1,231,800** (një milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).
- 2) “Auto Manoku Servis” SHPK **L62311016C**  
*Emri i plotë i shoqërisë* **numri i NIPT-it**  
Vlera: **1,323,900** (një milion e treqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).

- 3) **“KADIU” SHA** **J61817045K**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera: **1,579,700** ( një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind ) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).
- 4) **“SERVIS AUTO 2000” SHPK** **K31523078F**  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera: **1,254,530** ( një milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë ) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë).

*Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:*

➤ **“KADIU” SHA**

1. **Arsyeja e skualifikimit për “KADIU” SHA**

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, pika 2, pasi nuk arriti të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2016, 2017, 2018 ose 2017, 2018, 2019.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 1, pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk arriti të provojë se ka realizuar furnizime të ngjashme në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 2, pasi për punëtorinë e kërkuar nuk arriti të paraqesë listëpagesat (E-Sig 025), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, për periudhën Prill 2020 – Qershor 2020.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 3, pasi për Drejtuesin Teknik nuk ka paraqitur diplomë, kontratë pune, librezë punë.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 4, pasi për personelin teknik në profilet si: *Motorristë/ pompist, xhenerikë, elektroaut, diagnostikues difektesh elektrike & elektronike për automjetet dhe agregatet elektrike, bojaxhi, llamarinist, saldator, gomistë*, nuk arriti të paraqesë asnjë prej dokumenteve të kërkuar.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 5, pasi nuk arriti të vertetojë se ka në pronësi ose në përdorim 1 (një) ambient me sipërfaqe minimale 100 m<sup>2</sup>, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 6, pasi nuk arriti të paraqesë dokumentacionin që të të provojë se disponon pajisjet dhe instrumentet e kërkuar në DT.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 7, pasi nuk arriti të provojë se ka në dispozicion, minimalisht 1(një) karrotrec, për transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas.
- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 të kapacitetit teknik, pika 8, pasi nuk arriti të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

- |  |                         |
|--|-------------------------|
| 1) “ALSTEZO” SHA<br>Vlera: <b>1,231,800</b> lekë pa TVSH             | <b>Renditur i pari</b>  |
| 2) “SERVIS AUTO 2000” SHPK<br>Vlera: <b>1,254,530</b> lekë pa TVSH   | <b>Renditur i dyti</b>  |
| 3) “Auto Manoku Servis” SHPK<br>Vlera: <b>1,323,900</b> lekë pa TVSH | <b>Renditur i treti</b> |

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.08.2020;

Ankesa: Po

Kanë marrë përgjigje nga Organi Qendror Blerës në datë: 11.08.2020

Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik 437/2020 me datë 09.10.2020.

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**